



WWW.VULLNETARIZMI.AL

Udhëzues

Standardet Kombëtare për Kontributin e Vullnetarëve

2022

Udhëzues

**Standardet
Kombëtare për
Kontributin e
Vullnetarëve**

Autore

Irida Nasufi, Lubjana Malaj

Editoi

Irena Topalli, Ana Mullanji

Dizajni

Irena Topalli



Ky botim u realizua nga **Organizata Përtej Barrierave** dhe **Qendra "Progres dhe Zhvillim"** në kuadër të projektit strategjik "**VullnetarizmiPikëAL**", mbështetur nga "**LëvizAlbania**", projekti i **Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC**.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të u përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

Financuar nga **LevizAlbania**



Një projekt i **Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Përmbajtja

01

Hyrja

02

Përkufizimet

03

Çfarë është ky dokument

04

Dokumentat e konsultuara

05

Standardet Kombëtare për Përfshirjen e Vullnetarëve

Hyrja



Ka shumë evidenca që tregojnë se praktikat e vullnetarizmit po ndryshojnë në përgjigje të modeleve dhe sfidave më të gjera sociale, si emergjenca klimatike, përparimet teknologjike, migrimi, ndryshimi i natyrës së punës, krizat humanitare dhe pabarazitë, situata e pandemisë COVID-19. Për më tepër, për shkak të dallimeve kontekstuale dhe pabarazive, zhvillimi i infrastrukturës së përshtatshme vullnetare në nivel lokal dhe qendror është thelbësor për promovimin e një vullnetarizmi që është i qëndrueshëm.

Vullnetarizmi është pjesë e rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë. Kontributi i vullnetarëve ndikon në zhvillimin e mëtejshëm të rolit të shoqërisë civile dhe pjesëmarrjen aktive në ndërtimin e komuniteteve të forta dhe gjithëpërfshirëse. Vullnetarizimi qëndron në themel të inovacionit dhe ndryshimit social, përgjigjeve ndaj nevojave të komunitetit dhe sfidave të komunitetit, si dhe bashkon dhe mbështet në pikat e forta dhe burimet lokale të komuniteteve. Përfitimet janë të dyanshme si për ofruesit e vullnetarizmit dhe vetë vullnetarët. Vullnetarët ofrojnë kohën, aftësitë, ekspertizën dhe pikëpamjet që i mundësojnë një organizate/institucioni të ndjekë programe dhe aktivitete që shkojnë në përfitime për komunitetet.

Vullnetarët motivohen nga vlera si ato të drejtësisë, barazisë dhe lirisë, siç shprehen në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Një shoqëri që mbështet dhe inkurajon forma të ndryshme të vullnetarizmit ka të ngjarë të jetë një shoqëri që promovon gjithashtu mirëqenien e qytetarëve të saj. Vullnetarizmi është një shprehje bazë e marrëdhënieve njerëzore.

Marrëdhëniet shoqërore të brendshme të punës vullnetare janë kritike për mirëqenien individuale dhe të komunitetit. Vullnetarizmi është i mbushur me vlera të tilla si solidariteti, reciprociteti, barazia, besimi reciprok, përkatësia dhe fuqizimi, të cilat të gjitha kontribuojnë ndjeshëm në cilësinë e jetës.

Njerëzit në mbarë botën angazhohen në vullnetarizëm për një sërë arsyesh: për të ndihmuar në eliminimin e varfërisë dhe për të përmirësuar shëndetin dhe arsimin bazë, për të trajtuar çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike, për të zvogëluar rrezikun e fatkeqësive ose për të luftuar përjashtimin social. Në të gjitha këto fusha, vullnetarizmi jep një kontribut specifik duke gjeneruar mirëqenie për njerëzit dhe komunitetet e tyre. Një shoqëri e shëndoshë është ajo në të cilën i kushtohet rëndësi marrëdhënieve formale dhe joformale që lehtësojnë ndërveprimin dhe angazhimin dhe në këtë mënyrë krijojnë një ndjenjë përkatësie.

Në Shqipëri fillimet e rregullimit të vullnetarizmit lidhen me miratimin e Ligjit 45/2016 "Për Vullnetarizmin", i cili synon të përcaktojë parimet kryesore, kushtet dhe kriteret për kryerjen e vullnetarizmit. Ligji tentoi të bëhej më i aplikueshëm dhe i zbatueshëm vetëm pas miratimit të akteve nënligjore, që përfshinin Kodin e Etikës, Regjistrin e Vullnetarëve dhe Librezën e Vullnetarëve. Këto akte nënligjore u aprovuan në vitin 2018 dhe 2019, por prej tyre, vetëm Kodi i Etikës së Vullnetarit u bë publik. Sot, pas gjashtë vitesh nga miratimi i ligjit për vullnetarizmin gjendemi në situatën që ky ligj ka problematika me njohjen, kuptimin dhe



zbatimin e tij, si nga organizatat e shoqërisë civile, po ashtu edhe nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij.

Në gjithë këto vite nuk kanë munguar praktikatat pozitive të aktorëve të shoqërisë civile të cilët kanë punuar për të përmirësuar politikatat vullnetare dhe për të forcuar mjedisin institucional, ligjor, programatik dhe shoqëror rreth vullnetarizimit. Gjithashtu, ata kanë krijuar një mjedis të përshtatshëm për angazhimin e vullnetarëve të moshave të ndryshme, grupe të ndryshme etnike dhe ato socio-ekonomike, si dhe kanë sjell shumë shembuj dhe modele ndërkombëtare të vullnetarizimit në Shqipëri.

Përkufizimet



Vullnetarizmi

Vullnetarizmi është investimi me vullnet të lirë i kohës, njohurive dhe aftësive për kryerjen e aktiviteteve ose shërbimeve nga vullnetari, në dobi të ofruesit dhe/apo përfituesit të vullnetarizmit. Vullnetarizmi kryhet pa pagesë, pa kompensim ose ndonjë përfitim tjetër material, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe. (përkufizimi sipas Ligji 45/2016)

Vulletarë

Vulletarë janë të gjithë ata persona që kanë mbushur moshën për punë, që gjatë një periudhe të shkurtër referimi kryejnë aktivitete të papaguar dhe jo të detyrueshëm për të prodhuar mallra ose për të ofruar shërbime për të tjerët; të cilat shkojnë në benefit të palëve të treta jashtë familjes ose familjes së vullnetarit. (përkufizimi sipas ILO)

Standardet

Standardet janë parime të përgjithshme që shërbejnë për të siguruar cilësinë e kontributit vullnetar që do të ofrohet nga organizatat/institucionet. Ato i drejtojnë ofruesit e vullnetarizimit në plotësimin e nevojave të ndryshuara të përfituesve të tyre dhe të komunitetit në cilin ato ofrojnë shërbime.

Çfarë është ky dokument



Vendosja e standardeve për kontributin vullnetarë është e rëndësishme për të matur dhe ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga vullnetarët. Standardet kombëtare u zhvilluan bazuar në nevojën dhe problematikat mbi vullnetarizimin e raportuara nga studimi kombëtar, konferenca e parë kombëtare e vullnetarizimit, dokumenti politik, takimet konsultuese të zhvilluara me aktorë të ndryshëm në kuadër të projektit “VullnetarizmiPikëAI”, si dhe sfidat e shprehura ndërvite nga ofruesit e vullnetarizimit. Politikat dhe procedurat e shkruara krijojnë praktika shumë të mira për organizatat/institucionet që përfshijnë vullnetarë. Ato ofrojnë qartësi për të drejtat, përgjegjësitë dhe pritshmëritë që kanë ofruesit e vullnetarizimit për vullnetarët.

Prej viti 2016 Shqipëria ka një Ligj për vullnetarizimin (Ligji 45/2016)[1], ligj i cili në fakt ka sjellë një efekt të kundërt me atë që pritej, duke u bërë barrierë për organizatat e shoqërisë civile për shkak se është i fokusuar vetëm tek vullnetarizimi i strukturuar dhe lë jashtë çdo formë tjetër të vullnetarizimit. Organizatat e shoqërisë civile kanë reaguar dhe ngritur zërin fill pas miratimit të këtij ligji, duke kërkuar më shumë informacion, kanë dërguar letra, emaile, ankesa dhe rekomandime lidhur me problematikat e Ligjit për Vullnetarizimin. Qendra Burimore për Shoqërinë Civile në bashkëpunim me Organizatën Përtej Barrierave, kanë organizuar një seri takimesh me organizatat e shoqërisë civile në të gjithë vendin, tryeza informimi dhe kërkime që kanë pasur në fokus vullnetarizimin dhe rregullimin e tij me këtë ligj.

Për t’iu përgjigjur këtyre nevojave, projekti “VullnetarizmiPikëAI” i zbatuar nga Organizata Përtej Barrierave, Projekte Vullnetare Ndërkombëtare dhe Qendra Progres dhe Zhvillim, mbështetur nga grantet strategjike të Lëviz Albania, ka kontribuar gjatë gjithë zbatimit të tij në krijimin e një mjedisi mundësues shumë dimensional me qëllim që vullnetarizimi dhe praktikat e mira të njihen dhe të mbështen gjithmonë e më shumë për nxitjen e qytetarisë aktive.

Në Maj 2021 u mbajt **Konferenca e parë Kombëtare e Vullnetarizimit 1.0**, që kishte si qëllim të sillte të gjithë aktorët kyç në një tryezë për të krijuar një platformë kombëtare diskutimi dhe konsultimi mbi vullnetarizimin. Konferenca ishte një përpjekje për të nxitur bashkëpunimin ndërsektorial, përmirësimin e terrenit ligjor dhe social të vullnetarizimit në vend dhe të nxiste frymën e bashkëpunimit mes sektorit të ofruesve të vullnetarizimit. Një nga rekomandimet kryesore të propozuara në konferencë ishte dhe krijimi i një protokollit me standarde specifike i cili do të vinte në ndihmë ofruesve të vullnetarizimit për të ngritur dhe mirë menaxhuar sisteme të qëndrueshme të angazhimit të vullnetarëve.

Dokumenti i standardeve të kontributit të vullnetarëve është pjesë e një iniciative të ndërmarrë në kuadër të projektit VullnetarizmiPikëAI me qëllim që të sigurojë një kornizë për të udhëhequr dhe mbështetur sektorin e vullnetarizimit në Shqipëri.

[1] <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/04/28/45>



Standardet Kombëtare synojnë që të:

- përfshijnë vlerat si solidariteti, drejtësia sociale, respekti, integriteti, barazia dhe maksimizojnë përfitimet e përfshirjes vullnetare.
- zhvillojnë strategji dhe praktika efektive të përfshirjes vullnetare.
- rrisin përfshirjen e vullnetarëve në aktivitete kuptimplote dhe të dobishme që kontribuojnë në arritjen e rezultateve të institucioneve.
- sigurojnë që të drejtat e vullnetarëve të mbrohen dhe që ata të mbështeten për të kryer rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

Standardet do të rrisin cilësinë dhe profilin e vullnetarizmit në nivel lokal e kombëtar dhe do t'i ndihmojë vullnetarët të identifikojnë organizatat/institucionet që do t'u ofrojnë atyre role të sigurta dhe programe të strukturuar vullnetarizmi, bazuar në politika të qëndrueshme ku vullnetarët marrin një përvojë vullnetare pozitive me cilësi të lartë.

Në kushtet kur politikat dhe legjislacioni krijojnë me sukses një mjedis nxitës dhe mundësues për vullnetarizmin, njerëzit janë të pajisur me stimuj më të fortë për t'u përfshirë në veprime vullnetare. Kur hartohen dhe zbatohen me kujdes, skemat vullnetare mund t'i fuqizojnë njerëzit të marrin pjesë në komunitetet e tyre për të përmbushur objektivat e zhvillimit. Kështu, nevojitet prioritizimi i një infrastrukture vullnetare funksionale, të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse për t'u ofruar mundësi të gjithë qytetarëve që të bëhen agjentë të ndryshimit dhe nxitës të zhvillimit të tyre.

Organizata Përtej Barrierat në bashkëpunim me Qendrën Progres dhe Zhvillim kanë përgatitur këtë udhëzues që ka si qëllim që të ndihmojë organizatat dhe institucionet në punën e tyre me vullnetarët duke garantuar që të drejtat e vullnetarëve mbrohen dhe që ata mbështeten e udhëhiqen për të kryer me sukses rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

Dokumentat e konsultuara



Studimi kombëtar “**Vullnetarizmi në Shqipëri**” ofron të dhëna empirike lidhur me situatën e vullnetarizmit në Shqipëri në fillim të vitit 2021. Disa nga gjetjet kryesore të studimit tregojnë se **77% e pjesëmarrësve në studim besojnë se kontributi vullnetar në Shqipëri është shumë i nevojshëm. 90%, shprehen se nuk kanë informacion se ku dhe si mund të japin kontributin e tyre vullnetar. Pjesa më e madhe e të anketuarve 87%, nuk janë në dijeni të librezës së vullnetarit, dhe një pjesë e konsiderueshme 2/3 nuk kanë informacion as për Ligjin mbi Vullnetarizmin. Rreth 80% e ofruesve të vullnetarizmit nuk kanë informacion rreth Ligjit.**

Praktikat e menaxhimit dhe organizimit të vullnetarizmit nga institucione të ndryshme tregojnë se vullnetarizmi shihet si një aktiviteti cili nuk është i mirëorganizuar apo i strukturuar sipas një modeli të caktuar. Studimi nxjerr të dhëna se mungojnë praktika të mirëfillta dhe të mirëorganizuara të rekrutimit, orientimit, menaxhimit dhe vlerësimit të vullnetarëve singa institucionet qendrore, vendore, ashtu dhe ofruesit e vullnetarizmit, përfshirë këtu OSHC, qendra ditore, komunitare etj.

Dokumenti politik i hartuar nga Përtej Barrierave “**Njohja dhe nxitja e vullnetarizmit në Shqipëri përmes përmirësimit të kuadrit ligjor ekzistues**” sjell në vëmendje disa nga problematikat e “Ligjit Nr. 45 Për Vullnetarizmin” i miratuar në vitin 2016, i cili ka krijuar barriera duke e paralizuar vullnetarizmin dhe aktivitetin e organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë, të cilat janë dhe përdoruesi më i madh i shërbimit vullnetar në vend.

Pavarësisht se ligji synon të bëjë rregullimin ligjor të vullnetarizmit, me qëllim rritjen e angazhimit qytetar dhe rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën sociale, në praktikë efekti deri më tani është i kundërt. **Ligji ekzistues nuk i përgjigjet nevojave që kanë vullnetarët, ofruesit dhe përfituesit e shërbimit vullnetar në Shqipëri dhe më tej krijon barriera të konsiderueshme.** Është e domosdoshme që të bëhen ndryshime përkatëse, për të krijuar një mjedis legjislativ mundësues që nxit vullnetarizmin në të gjitha format e tij.

Neni 38 i Kartës së vullnetarizmit “Karta Evropiane për të drejtat dhe përgjegjësitë e vullnetarëve” parashikon që ofruesit e vullnetarizmit angazhohen për zhvillimin dhe zbatimin e standardeve të cilësisë që sigurojnë përgatitjen dhe informimin, ofrojnë udhëzime personale, ndihmë dhe monitorim gjatë gjithë procesit, mekanizma të qartë vlerësimi dhe mbështetje të plotë në realizimin e aktiviteteve të kërkuara[2]. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara ofrojnë kuadrin për forcimin e pronësisë lokale të agjendës së zhvillimit përmes veprimeve vullnetare. Axhenda e vitit 2030 gjithashtu vendos bazën për një fokus urgjent në të kuptuarit se si të zhvillohet infrastruktura e vullnetarizmit dhe për të identifikuar masat kryesore që mund të promovojnë një mjedis të favorshëm për vullnetarizmin. Plani i veprimit për integrimin e vullnetarizmit në paqe dhe zhvillim e vendos vullnetarizmin në qendër të një qasjeje strategjike dhe afatgjatë për politikën dhe programet që synojnë zbatimin e Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm [3].



Bashkimi Evropian është ndërtuar mbi solidaritetin, një vlerë e përbashkët e cila ndihet fuqishëm në të gjithë shoqërinë evropiane. European Solidarity Corps bashkon të rinjtë për të ndërtuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse, duke mbështetur njerëzit vulnerabël dhe duke iu përgjigjur sfidave të shoqërisë. Aktivitetet e European Solidarity Corps mbështesin objektivat e Strategjisë Rinore të BE-së të miratuar për 2019–2027, e cila inkurajon të rinjtë të bëhen qytetarë aktivë. European Solidarity Corps bazohet në arritjet e më shumë se 25 viteve të programeve evropiane në fushën e rinisë dhe solidaritetit, veçanërisht në suksesin e Shërbimit Vullnetar Evropian[4]. Vitet e fundit, vlera sociale dhe ekonomike e vullnetarizmit ka patur një vëmendje të rëndësishme brenda politikës evropiane.

Forumi Ndërkombëtar për Vullnetarizmin në Zhvillim, krijojë në vitin 2016 standardin e parë të miratuar globalisht për organizatat që përfshijnë vullnetarë. Qëllimi kryesor i Forumit në krijimin e Standardit Global të Vullnetarizmit ishte të promovonte dhe mbështeste një vullnetarizëm me më shumë ndikim dhe të përgjegjshëm. Për të arritur këtë, puna e organizatave vullnetare duhet të jetë e mirëplanifikuar, transparente dhe e respektueshme; e bazuar në partneritete të vërteta dhe rezultate të matshme. Standardi Global i Vullnetarizmit është një standard praktike që organizatat/institucionet që përfshijnë vullnetarë mund të zgjedhin ta përvetësojnë plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë që të mësojnë, përmirësojnë dhe të jenë në një linjë me një grup praktikash të mira, gjithëpërfshirëse të dakordësuara globalisht[5].

[2] European Youth Forum, 2012. Volunteering charter. European charter on the rights and responsibilities of volunteers
[3] United Nations General Assembly (UNGA). (2015a). Integrating volunteering in the next decade. Report of the Secretary-General (A/70/118). New York.

[4] European Commission (2021). European Solidarity Corps.
[5] Forum (2021). The global volunteering standard.



Standardet Kombëtare për Kontributin e Vullnetarëve

Qëllimet dhe Parimet

Standardet Kombëtare për Kontributin e Vullnetarëve (Standardet Kombëtare) shërbejnë për të mbështetur përfshirjen e vullnetarëve dhe për të vepruar si një burim për ofruesit e vullnetarizmit. Ato ofrojnë një kornizë për organizatat/institucionet që të marrin në konsideratë rolin e vullnetarëve brenda strukturave të tyre dhe ndikimin që mund të ketë përfshirja efektive e vullnetarëve në arritjen e qëllimeve dhe synimeve strategjike të organizatës/institucionit.

Standardet Kombëtare janë krijuar për të ndihmuar ofruesit e vullnetarimit:

- të bazohet në vlerat dhe të maksimizojë përfitimet e përfshirjes vullnetare
- të zhvillojë strategji dhe praktika efektive të përfshirjes vullnetare
- të përfshijë vullnetarët në aktivitete kuptimplota dhe të dobishme që kontribuojnë në rezultatet e punës së organizatës/institucionit
- të sigurojë që të drejtat e vullnetarëve mbrohen dhe që ata mbështeten e udhëhiqen për të kryer me sukses rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

Standardet Kombëtare përfshijnë parimet e mëposhtme:

- Përfshirja e vullnetarëve duhet të planifikohet dhe të jetë pjesë e zhvillimit strategjik të organizatës/institucionit, në përputhje me qëllimet strategjike dhe të bëhet pjesë edhe e kornizës së saj të vlerësimit.
- Përfshirja efektive e vullnetarëve kërkon udhëheqje organizative, një kulturë dhe strukturë që mbështet dhe vlerëson rolin dhe kontributin e vullnetarëve.
- Vullnetarët kanë të drejta, që përfshijnë të drejtën për të punuar në një mjedis të sigurt dhe mbështetës me infrastrukturë të përshtatshme dhe praktika menaxheriale efektive.
- Vullnetarët kanë përgjegjësi, që përfshijnë përgjegjësin për veprimet e tyre ndaj organizatës/institucionit, respektimin e vlerave dhe praktikave të organizatës/institucionit.



Vullnetarët ofrojnë për organizatat/institucionet një pjesë të konsiderueshme të kohës së tyre.

Organizatat/institucionet duhet të kuptojnë sesi duhet ti mbështesin vullnetarët e tyre dhe t'i trajtojnë ata me dinjitet. Ky dokument përcakton disa standarde bazë minimale të menaxhimit të mirë të vullnetarëve dhe do të ndihmojë në njohjen e vlerës së madhe të kontributeve të vullnetarëve. Duke pranuar dhe zbatuar këtë udhëzues të standardeve kombëtare të kontributit të vullnetarëve, organizatat/institucionet angazhohen jo vetëm për të forcuar strategjinë e tyre të angazhimit të vullnetarëve, por edhe për të forcuar kapacitetin e organizatës/institucionit për të përmbushur mandatin e saj dhe për të kontribuar për një komunitet më të fortë. Dokumenti i standardeve është krijuar për të zhvilluar më tej mendimin dhe për të diktuar brenda organizatave/institucioneve rreth rolit të vullnetarëve dhe ndikimit që mund të ketë angazhimi efektiv i tyre në arritjen e qëllimeve strategjike dhe avancimin e misionit të organizatës/institucionit.

Standardet Kombëtare lejojnë organizatat të përdorin kritere të thjeshta praktike në një gamë të gjerë situatash me vullnetarët.

Ekzistojnë **8 standarde** që trajtojnë fushat kryesore të përfshirjes vullnetare[6]:

- **1. Drejtimi dhe menaxhimi**
- **2. Angazhimi për përfshirje vullnetare**
- **3. Rolet e vullnetarëve**
- **4. Rekrutimi dhe përzgjedhja**
- **5. Mbështetja dhe zhvillimi**
- **6. Siguria dhe mirëqenia në vendin e punës**
- **7. Njohja e kontributit vullnetar**
- **8. Menaxhimi i cilësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm**

Çdo standard përmban qëllimin e standardit dhe kriteret sipas të cilave mund të vlerësohet niveli i arritjes së standardit. Standardet kombëtare janë kryesisht për organizatat/institucionet që përfshijnë vullnetarë në personelin e tyre. Ato nuk kanë për qëllim të aplikohen në aktivitetet e vetë vullnetarëve.

[6] Volunteering Australia 2015. The national standards for volunteer involvement.



Organizatat/institucionet mund të përdorin Standardet Kombëtare në disa mënyra

- si një udhëzues i përgjithshëm për praktikën e mirë të vullnetarizimit në nivel kombëtar;
- si një mjet auditimi/kontrolli që ofron një pasqyrë se sa mirë po performon organizata/institucioni përkundrejt praktikave më të mira për përfshirjen vullnetare;
- si një udhëzues ose listë kontrolli për të ndihmuar në identifikimin e mundësive për të bërë përmirësime;
- si një kornizë referimi për të ndihmuar në planifikimin dhe krijimin e një shërbimi të ri vullnetar;
- si bazë nga e cila mund të monitorohet dhe matet progresi në arritjen e përmirësimeve;
- si një mënyrë për të fituar njohje formale për praktikën e mirë të vullnetarizimit që përmbush Standardet Kombëtare.

Standardet synohet të jenë mjaft fleksibël për t'u zbatuar nga organizata/institucione të madhësive të ndryshme me nivele të ndryshme burimesh, si në mjediset rurale ashtu edhe ato urbane, të udhëhequra nga punonjës ose nga vullnetarë. Dokumenti i standardeve njih dhe pasqyron realitetet në ndryshim të angazhimit vullnetar dhe praktikës së menaxhimit, dhe mbështet punën e atyre që menaxhojnë dhe mbështesin angazhimin vullnetar brenda një organizate/institucioni. Ky dokument është krijuar për të qenë gjithëpërfshirës dhe mund të përshtatet për t'u zbatuar për një shumëllojshmëri njerëzish, kulturash, komunitetesh, mundësish dhe qasjesh.

Disa standarde ose kritere mund të zbatohen vetëm për situata të veçanta vullnetare.

STANDARDI 1



DREJTIMI DHE MENAXHIMI

Ofruesit e vullnetarizmit drejtojnë dhe promovojnë një kulturë pozitive, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të vullnetarizmit përmes sistemeve efektive të menaxhimit dhe përfshirjes vullnetare.

1.1 Përcaktohen përgjegjësitë për drejtimin dhe menaxhimin e vullnetarëve në linjë me vizionin, misionin, qëllimin dhe vlerat e organizatës/institucionit.

1.2 Ofruesit e vullnetarizmit zhvillojnë politika dhe procedura të qarta të angazhimit dhe përfshirjes së vullnetarëve, të cilat komunikohen, kuptohen dhe zbatohen nga i gjithë stafi përkatës në të gjithë organizatën/institucionin.

1.3 Ofruesit e vullnetarizmit krijojnë një bazë të dhënash mbi përfshirjen, angazhimin dhe kontributin e vullnetarëve.

1.4 Baza e të dhënave të vullnetarëve unifikohet për të gjithë organizatat/institucionet me qëllim që të dhënat e mbledhura të shërbejnë për analizimin e kostove dhe informacioneve të tjera të kontributit të vullnetarëve.

1.5 Në aktivitete vullnetare të përbashkëta ndahen rolet dhe përgjegjësi me agjencitë partnere.

STANDARDI 2



ANGAZHIMI PËR PËRFSHIRJE VULLNETARE

Ofruesit e vullnetarizimit zhvillojnë një qasje të angazhimit dhe përfshirjes së vullnetarëve që përcaktohet përmes vizionit, planifikimit dhe burimeve të duhura financiare dhe njerëzore, dhe mbështet drejtimin strategjik të organizatës.

2.1 Ofruesit e vullnetarizimit përcaktojnë qëllimin dhe angazhimin e tyre për të përfshirë vullnetarët.

2.2 Përfshirja e vullnetarëve është planifikuar dhe kontribuon drejtpërdrejt në arritjen e qëllimit dhe objektivave të organizatës.

2.3 Planifikohet një buxhet për përfshirjen e vullnetarëve.

STANDARDI 3



ROLET E VULLNETARËVE

Vullnetarët janë të angazhuar në role dhe detyra kuptimplote që kontribuojnë në qëllimin dhe objektivat e organizatës/institucionit.

3.1 Përcaktohen rolet dhe detyrat e vullnetarëve bazuar në programet e vullnetarëve të cilat kontribuojnë në përmbushjen e qëllimit dhe objektive të organizatës/institucionit.

3.2 Çdo vullnetar/e njihet me rolet dhe detyrat të cilat përfshijnë përshkrime të shkruara mbi detyrat, përgjegjësitë, aftësitë, kohën e nevojshme dhe përfitimet.

3.3 Rolet dhe detyrat e vullnetarëve përcaktohen, dokumentohen dhe komunikohen.

3.4 Rolet dhe detyrat e vullnetarëve rishikohen periodikisht me stafin dhe vullnetarët bazuar në të dhënat që mblidhen nga vullnetarët dhe punonjësit.

3.5 Vullnetarët duhet t'i konsiderojnë të gjitha informacionet në të cilat kanë akses ose që u jepen si rezultat i vullnetarizmit të tyre si konfidencial, përveç rasteve kur këshillohet ndryshe.

STANDARDI 4



REKRUTIMI DHE PËRZGJEDHJA

Strategjitë e rekrutimit dhe përzgjedhjes së vullnetarëve janë realiste dhe të qarta në lidhje me pritshmëritë e vullnetarëve, të planifikuara, të qëndrueshme dhe plotësojnë nevojat e organizatës/institucionit dhe vullnetarëve.

4.1 Ofruesit e vullnetarizmit rekrutojnë vullnetarë, përmes një qasje të planifikuara për të tërhequr vullnetarë me interesa, njohuri, aftësi ose attribute përkatëse.

4.2 Vullnetarët potencial pajisen me informacionin përkatës në lidhje me organizatën/institucionin, rolin e vullnetarëve dhe procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes.

4.3 Vullnetarët përzgjidhen në bazë të interesit, njohurive dhe aftësive ose attributeve të rëndësishme për rolin që do të kenë në organizatë/institucio, dhe përzgjedhen vullnetarë nga një gamë e gjerë prejardhjesh dhe përvojash për të përfaqësuar komunitetin që i shërben organizata/institucioni.

4.4 Vullnetarizmi është i hapur pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, bindjes politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, ose çdo arsye tjetër që përbën shkak për diskriminim.

4.5 Ofruesit e vullnetarizmit zbatojnë proceset e selektimit për vullnetarët me qëllim që të garantohet një proces i drejtë dhe i barabartë për gjithë përfituesit.

STANDARDI 5



ORIENTIM, MBËSHTETJE DHE ZHVILLIM

Vullnetarët i kuptojnë rolet e tyre dhe marrin një orientim, mbështetje të përshtatshme për të kryer në mënyrë të sigurt dhe efektive detyrat e tyre.

5.1 Vullnetarët mbështeten dhe ju ofrohet orientim në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e tyre.

5.2 Vlerësohen njohuritë, kapacitetet dhe aftësitë e vullnetarëve për të identifikuar nevojat për mbështetje dhe zhvillim.

5.3 Bazuar në rolet dhe përgjegjësitë që do të marrin vullnetarët në organizatë/institucion ju ofrohen trajnime për rritjen e kapaciteteve dhe mundësi zhvillimi sipas fushave në të cilat do angazhohen.

5.4 Vullnetarëve ju ofrohet supervizim dhe mbështetje me qëllim që të përmirësojnë cilësinë e punës së tyre për të arritur objektivat dhe rezultatet e planifikuara.

5.5 Vullnetarëve u jepet mundësia dhe inkurajohen që të përdorin mekanizma për të ofruar kontribut për organizatën/institucionin.

STANDARDI 6



SIGURIA DHE MIRËQENIA NË VENDIN E PUNËS

Shëndeti, siguria dhe mirëqenia e vullnetarëve mbrohet në vendin e punës.

6.1 Marrëdhëniet efektive të punës me punonjësit dhe ndërmjet vullnetarëve, lehtësohen nga organizata/institucioni.

6.2 Krijohen procedura për të siguruar menaxhimin e rrezikut, mbrojtjen, shëndetin dhe mirëqenien e vullnetarëve, organizatës/institucionit dhe të tjerëve.

6.3 Vullnetarët kanë përgjegjësi personale për të ndjekur rregulloret dhe udhëzimet në lidhje me shëndetin dhe sigurinë dhe për të respektuar rregullat e punës.

6.4 Ofruesit e vullnetarizimit ndjekin politika dhe procedura përkatëse për të garantuar mbrojtjen, sigurinë dhe dinjitetin e të gjithë të interesuarve. Vullnetarët janë të informuar dhe kanë akses në procedurat e ankesave.

STANDARDI 7



NJOHJA E KONTRIBUTIT TË VULLNETAREVE

Kontributi, vlerat dhe impakti i punës së vullnetarëve njihet, vlerësohet dhe pranohet në mënyrë të vazhdueshme.

7.1 Ofruesit e vullnetarizimit vlerësojnë kontributin e vullnetarëve për organizatën/institucionin, përfituesit e shërbimeve dhe komunitetin.

7.2 Vullnetarët informohen sesi organizata/institucioni, përfituesit e shërbimeve dhe komuniteti përfitojnë nga kontributet e tyre.

7.3 Ofruesit e vullnetarizimit njohin rregullisht kontributet e vullnetarëve dhe impaktin pozitiv në organizatë/institucion, tek përfituesit e shërbimeve dhe komunitet dhe përdorin metoda formale dhe joformale të njohjes në kohën dhe në mënyrën e duhur.

7.4 Ofruesit e vullnetarizimit përdorin një instrument certifikimi për njohjen, dokumentimin dhe vërtetimin e kontributit dhe zhvillimin e kompetencave të vullnetarit, si rezultat i angazhimit në programet e vullnetarëve.

STANDARDI 8



MENAXHIMI I CILËSISË DHE PËRMIRËSIMI I VAZHDESHËM

Përfshirja efektive e vullnetarëve duhet të vlerësohet rregullisht për të siguruar që po kontribuon në një sistem praktikash të mira, rezultatesh dhe përmirësimi të vazhdueshëm.

8.1 Politikat dhe procedurat rishikohen dhe zbatohen për të udhëhequr në mënyrë efektive të gjitha aspektet e përfshirjes dhe kontributit vullnetarë.

8.2 Përfshirja e vullnetarëve rishikohet rregullisht në përputhje me legjislacionin përkatës, kuadrin e vlerësimit, dhe menaxhimit të cilësisë së organizatës/institucionit.

8.3 Performanca e kontributit të vullnetarëve monitorohet, vlerësohet dhe raportohet te ofruesit e vullnetarizimit, vullnetarët dhe palët e interesuara.

8.4 Vullnetarët ftohen që të japin feedbackun e tyre për rolin e organizatës/institucionit në përfshirjen e vullnetarëve dhe rezultateve të arritura në fushat përkatëse të punës së organizatës/institucionit.



www.vullnetarizmi.al
info@vullnetarizmi.al

Adresa:

Pertej Barrierave
Rr.Don Bosko , Pall Gener 2,
Kati 6, AP 51, –Tiranë, Shqipëri

www.beyondbarriers.org
office@beyondbarriers.org

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDG



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun Svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDG